



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
ARKIVI QËNDROR TEKNIK I NDËRTIMIT**

Nr. 6 Prot.

Tiranë, më 06.01.2025

**URDHËR I BRENDSHËM
PËR
SHËRBIMET QË KRYHEN NË
ARKIVIN QËNDROR TEKNIK TË NDËRTIMIT (AQTN)**

Shërbimi në Arkivin Qëndror Teknik të Ndërtimit bazohet Ligjin Nr.9254, datë 06.07.2003 dhe Udhërit Nr.153, datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e disopizitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data 01.01.2020”

Nga data 01.01.2020 katër shërbimet e implementuara në platformën e-Albania (*Marrje Gen-Plani A3/A4, Marrje Dosje Pronësie, Marrje Fletë Projekti dhe shikim materiali teknik*) në bazë të Kontratës Nr. **1831/19 dt.16 dhjetor 2015** midis FASTECH dhe AQTN, “*Shërbimet Online të AQTN dhe Shkëmbimi digjital i Informacionit me Entet Publike (Integrimi i 5 shërbimeve në Platformën e-Albania)*” ofrohen vetëm online si dhe duke filluar nga data 30.06.2020 kësaj liste u shtohen edhe 14 shërbimet e tjera (të listës së shërbimeve) që do të shërbehen vetëm online në e-albania.

Bazuar në e-mail datë 23.01.2023 të Drejtorisë së Menaxhimit TIK në MIE, janë bërë ndryshime mbi mënyrën e pagesës nga ana e aplikantit, për marrjen e dokumentit arkivor të ngarkuar në backend-in e programit Arkiva Digjitale të AQTN-së.

Për zbatimin e kriterëve të miratuara, të ndiqet kjo praktikë pune :

1. Aplikim për shërbimin, bëhet nëpërmjet portalin e-albania duke bërë përzgjedhjen e shërbimit.

2. Pas dërgimit me sukses të aplikimit, merret nga Përgjegjësi i Fondit Arkivor në BO (Back Office) dhe i dorëzohet përpunueses të dokumentacionit, e cila e dorëzon në specialistet e fondit përkatës.
3. Aplikimi merret nga specialisti i fondit përkatës, kontrollon dhe gjen dokumentacionin arkivor, dhe pasi bindet që dokumentacioni i gjetur është ai për të cilin bëhet fjalë në aplikim, ia jep përpunueses së dokumentave, e cila përgatit shumëfishimin e dokumentit dhe kthen dokumentin në fond brenda orarit zyrtar.
4. Përpunuesja e dokumentacionit pasi bën shumëfishimin e dokumentacionit, ia jep administratorit të dokumentave, që bën përgatitjen, sistemimin e firmosjen tek specialisti i arkivit, përgjegjësi i fondit arkivor dhe Titullari i institucionit.
5. Mbas firmosjes së dokumentit të aplikuesit nga Titullari i institucionit, administratori i dokumentacionit ia kalon Përgjegjësit të Fondit Arkivor për plotësimin e aplikimit në backend-in e programit Arkiva Digjitale të AQTN-së në portalin e e-albania, ku ngarkohet aplikimi i plotësuar dhe plotësohet fatura e aplikimit.
6. Afati i plotësimit të aplikimit në portalin e-albania (backend-i i programit Arkiva Digjitale të AQTN-së) është brenda 5 ditë pune,
7. Me aprovimin e aplikimit në backend-in e programit Arkiva Digjitale të AQTN-së, aplikanti kryen pagesën online ose me ngarkim Mandat Pagesë.
8. Me shkarkimin e faturës të gjeneruar në backend-in e programit Arkiva Digjitale të AQTN-së, aplikuesi kryen pagesë në bankë.
9. Aplikuesi përveç butonit paguaj (në gjurmim të aplikimit të tij në portal) ka aktiv butonin Ngarko Mandat Pagesë.
10. File i Mandat Pagesës i ngarkuar nga aplikanti do shfaqet në seksionin Dokumentet e Aplikantit në backend-in e programit Arkiva Digjitale të AQTN-së.
11. Përgjegjësia e Fondit Arkivor mbas printimit të Mandat Pagesës ia dorëzon punonjëses të autorizuar nga Drejtoria për verifikimin e pagesës në llogari të institucionit.
12. Pas verifikimit të Mandat Pagesës, Përgjegjësia e Fondit Arkivor në backend-in e programit Arkiva Digjitale të AQTN-së bën regjistrimin e pagesës në seksionin Krijo Pagesë.

13. Me regjistrimin e pagesës aplikuesit automatikisht i bëhet aktiv butoni Dokumentet nga ku ai bën shkarkimin e shërbimit të dokumentit të kërkuar.
14. Plotësimi i aplikimit për materialin që nuk disponojmë bëhet duke verifikuar dokumentacionin nga specialistet përkatëse me përgjegjësi, duke firmosur në aplikimin e marrë.
15. Për efekt pronësie dokumentacionet hartografike, që s'kanë datë fikse, njësi të shkallës, emërtim apo firmë të autorit, të mos jepen për riprodhime.
16. Dokumentacioni hartografik origjinal, mbi të cilin janë bërë punime nuk do të shërbejë si dokumentacion zyrtar, por vetëm si objekt studimi.

Çdo shkelje e këtij Urdhri të Brendshëm për mënyrën e shërbimit në AQTN-in, vë secilin specialist para përgjegjësisë administrative dhe penale
Zbatimi i Urdhrit fillon nga data 06.01.2025

DREJTORI

Gjergj THOMAI

